REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR

KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR. 100 **DT.** 16 / 12 **/2022**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

" PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 DHE BUXHETIT VJETOR 2023"

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 16. 12. 2022 pasi shqyrtoi materialin e relatuar nga Kryetari i Bashkisë "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023", në mbështetje të ligjit nr.9936 dt 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar , ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit 68/2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligjit 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, ligjit 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri", ligjit 79/2017 "Për sportin", ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile" , VKM nr 1108, date 30.12.2015 "Për transferim nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të bashkisë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe aseteve te luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit, VKM nr 915, date 11.11.2015 "Për transferim në pronësi, nga këshillat e qarqeve të bashkive, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme të ndërmarjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve" VKM nr 433, "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyje, kullotave publike sipas inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave", VKM nr 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.23, datë 30.07.2018 " Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", Vendimit nr 158, datë 12.03.2022 "Për përcaktmin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendimit nr 604, datë 14.09.2022 "Për përcaktmin e pagës minimale në shkallë vendi", dhe shkresën nr 21863, datë 24.11.2022 nga MFE me objekt "Mbi hartimine e PBA 2023-2025 dhe buxhetit vjetor 2023, për bashkitë pilot (Gjirokastër, Korcë, Mirditë)", shkresës nr 19206, datë 19.10.2022 nga MFE me objekt "Dërgohet për njoftim transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale, për vitin 2023".

SINGH
SE
JASH

VENDOSI:

1. Të miratojë buxhetin e Bashkisë Gjirokastër për vitin 2023 sipas përcaktimit të nentit 40, të ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore"
2. Të mirtoj treguesit e buxhetit 2023 si më poshtë

I

A- Të ardhura gjithësej 705 990

A.1 Të ardhurat e veta të planifikuara për 2023.....230 477

B- Transferta gjithësej.....475 513

B.1 Transferta e përgjithshme e pakushtëzuar.....253 364

B.2 Transferta e pakushtëzuar sektoriale.....222 149

II

A- Shpenzime personeli..... 462 249

B- Shpenzime mallra dhe shërbime..... .134 636

C- Transfertë Akademisë së Futbollit Luftëtari 15 000

D- Fondi rezervë..... 4 162

E- Fondi kontigjencës.....4 162

F- Fondi emergjencës nga të ardhurat e veta.....2 000

G- Shpenzime kapitale..... 83 781

3. Për kompetencë të kryetarit të bashkisë
   a) Rishpërndarja e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program.
   b) Rishpërndarja ndërmjet zërave të shpenzimeve koherente, brenda të njëjtit program, (600-601-602).
   c) Përdorimi i fondit të veçant sipas legjislacionit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

LAVDI HASANI

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

BASHKIA GJIROKASTËR

PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
2023 – 2025
DHE BUXHETI VJETOR 2023

DHJETOR 2022

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 5

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR 5

1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË 7

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË GJIROKASTËR 10

3. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË GJIROKASTËR 2023-2025 12

3.1 TË ARDHURAT E BASHKISË GJIROKASTËR NË VITET 2023-2025 12

3.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Gjirokastër. 16

3.1.2 Burimet e të ardhurave dhe metodologjia e parashikimit afatgjatë të tyre 17

3.1.3 Të Ardhurat nga Taksat e Ndara 29

3.1.4 Kapacitetet fiskale të taksapaguesve 31

3.1.5 Transfertat nga pushteti qëndror 46

3.2 PLANI I SHPENZIMEVE TË BASHKISË GJIROKASTËR PËR PERIUDHËN 2023-2025 48

3.3 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR 57

4. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE 61

PROGRAMI AA115 64

PROGRAMI AB115 72

PROGRAMI AC115 80

PROGRAMI AD115 96

PROGRAMI AE115 110

PROGRAMI AF115 119

PROGRAMI AG115 135

5. BUXHETI VJETOR 2023 154

Lista e Tabelave

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Gjirokastër 11

Tabela 2.Burimet buxhetore 12

Tabela 3. Taksa mbi ndërtesën 19

Tabela 4. Taksa mbi tokën bujqësore 20

Tabela 5. Taksa e tabelës 24

Tabela 6. Taksa e fjetjes ne hotel. 26

Tabela 7. Taksa ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja dhe sherbime te tjera 26

Tabela 8. Tarifat e pastrimit për biznesin e vogël dhe të madh 31

Tabela 9. Tarifat e ndriçimit për biznesin e vogël dhe të madh 35

Tabela 10. Tarifa e gjelbërimit 39

Tabela 11. Tarifa e përkohëshme për biznesin. 40

Tabela 12. Tarifa dhe taksa për abonetë familjarë 41

Tabela 13. Tarifa dhe shërbime të tjera 41

Tabela 14. Tarifa dhe shërbime të tjera 44

Tabela 15. Tarifat për veprimtaritë e teatrit dhe kinemasë. 45

Tabela 16. Shpenzimet totale të Bashkisë 48

Lista e Shkurtimeve

PBA	– Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVQV	– Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP	– Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS	– Grupi për Menaxhimin Strategjik
MFE	– Ministria e Financave dhe Ekonomisë
FPT	– Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT	– Instituti i Statistikave
PBB	– Produkti i Brendshëm Bruto

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës* së *Programit,* synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit).

[1] Specifike, Matshme, Arritshme, Rëndësishme, Terma Kohore.

[2] 'Afatgjat' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

[3] Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit,* synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart[4] i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;

[4] Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"

- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2023-2025 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin

Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË GJIROKASTËR

Bashkia Gjirokastër administron një sipërfaqe prej 478 Km2 dhe ka një popullsi prej 52.000 banorësh sipas gjendjes civile. Në zbatim të ligjit 115 "Për reformën administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverrisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" Bashkia Gjirokastër përbëhet nga Njësia Administrative qytet dhe gjashtë njësi të tjera të cilat janë: Njësia Administrative Picar, Njësia Administrative Cepo, Njësia Administrative Lunxhëri, Njësia Administrative Lazarat dhe Njësia Administrative Odrie me 31 fshatra. Në zbatim të ligjit 115 "Për reformën administrativo-territoriale të njësive të vetëqeverrisjes vendore në Republikën e Shqipërisë" Bashkia Gjirokastër është rritur si në sipërfaqe ashtu edhe në funksione. Për përmbushjen e objektivave të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj kominitetit Bashkia Gjirokastër funksionon në zbatim të ligjeve prej të cilëve janë hartuar metodologji dhe udhëzime të brendshme të cilat garantojnë konsolidim të vlerësimit të të ardhurave dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve në komunitet.

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Gjirokastër

Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë						
	Të Pergjithshme	2018	2019	2020	2021	2022
Numri i Njësive Administrative	7.0					
Numri i Fshatrave	31.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	478km2					
Qyteti	4,093.0					
Njësitë Administrative	39,963.0					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	-					
Zonë Urbane	4,093.0					
Tokë Bujqësore	6,793.0					
Kullotë	12,452.0					
Pyje	10,170.8	-				
Popullsia e Bashkisë		52,030	52,029	51,875	51,573	50,541
Qytetit		33,713	33,710	33,652	33,473	32,803
Njësitë Administrative		18,317	18,319	18,223	18,100	17,738
Mosha Mesatare e Popullsisë		-	-	-	-	-
Numri i Lindjeve		247	321	322	124	96
Numri i Vdekjeve		253	264	333	158	91
Numri i Biseseve Aktive		1,082	1,078	1,105	1,250	1,304
Numri i Familjeve		16,520	16,864	17,058	17,137	9,304
Qyteti		11,293	11,539	11,671	11,751	6,311
Njësitë Administrative		5,227	5,325	5,387	5,386	2,993
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Plotë		625	612	610	617	617
Administrata e Bashkisë		122	-	-	-	-
Njësitë Shpenzuese		503	-	-	-	-
Numri i Punonjësve të Bashkisë me Kohë të Pjesëshme		39	39	47	47	55
Administrata e Bashkisë		-	-	-	-	-
Njësitë Shpenzuese		-	-	-	-	-
Numri i Programeve Buxhetore		12	12	12	13	13

3. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË GJIROKASTËR 2023-2025

3.1 Të Ardhurat e Bashkisë Gjirokastër në vitet 2023-2025

Kjo nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

Tabela 2. Burimet buxhetore

	BURIMET BUXHETORE	2020	2021	2022	2023	2024	2025
		Fakti	Fakti	Buxh. Fillestar	Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	173,047	199,782	210,370	230,477	232,781	235,109
A.1	Të Ardhura nga Taksat Lokale	40,274	45,969	50,748	53,510	54,044	54,582
A.1.1	Taksa vendore mbi biznesin e vogël	2,345	-	-	-	-	-
A.1.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	34,193	38,082	44,573	48,286	48,768	49,254
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	29,053	30,083	37,297	39,405	39,799	40,196
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	3,999	4,358	6,425	7,020	7,090	7,161
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	461	728	127	1,137	1,148	1,159
A.1.2.4	Taksa mbi transaksionet e pasurisë	680	2,913	724	724	731	738
A.1.3	Taksa vendore në shërbimin hotelier	372	994	1,175	1,224	1,236	1,248
A.1.4	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	2,963	6,625	5,000	4,000	4,040	4,080
A.1.5	Taksa e tabelës	-	1	-	-	-	-
A.1.6	Taksa vendore mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimi, testament dhe llot. Vend.	-	-	-	-	-	-
A.1.7	Taksa e përkohëshme	401	267	-	-	-	-
A.1.8	Taksa e përkohëshme 1	-	-	-	-	-	-
A.1.9	Taksa e përkohëshme 2	-	-	-	-	-	-
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	25,060	31,635	27,240	27,415	27,689	27,968
A.2.1	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasurisë e paluajtshme	-	-	-	-	-	-

A.2.2	**Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura**	18,594	22,451	21,240	21,239	21,451	21,667
A.2.3	**Taksa e rentës minerare**	-	-	-	-	-	
A.2.4	**Taksa mbi të ardhurat personale**	6,466	8,531	6,000	6,000	6,060	6,121
A.2.5	**Taksa të tjera**	-	653	-	176	178	180
A.3	**Të Ardhurat nga Tarifat Vendore**	85,836	99,889	108,206	126,625	127,892	129,172
A.3.1	**Tarifa me menaxhimit te mbetjeve**	29,222	35,147	43,663	51,267	51,779	52,296
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	17,521	17,814	16,170	22,621	22,847	23,075
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	720	1,380	5,068	2,210	2,232	2,254
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	10,981	15,953	22,425	26,436	26,700	26,967
A.3.2	**Tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve**	-	-	-	-	-	-
A.3.3	**Tarifa për ndriçimin publik**	22,732	23,105	27,592	29,947	30,247	30,550
A.3.3.1	Tarifa për ndriçimin publik nga familjet	16,826	14,938	13,844	17,007	17,177	17,349
A.3.3.2	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	360	780	3,363	990	1,000	1,010
A.3.3.3	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	5,546	7,387	10,385	11,950	12,070	12,191
A.3.4	**Tarifa për gjelbërimin**	6,044	6,306	8,047	6,999	7,069	7,139
A.3.4.1	Tarifa për gjelbërimin nga familjet	6,044	6,306	3,793	2,872	2,901	2,930
A.3.4.2	Tarifa për gjelbërimin nga institucionet	-	-	350	340	343	346
A.3.4.3	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	-	-	3,904	3,787	3,825	3,863
A.3.5	**Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë**	19,374	23,909	15,309	23,250	23,483	23,719
A.3.5.1	Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë	774	-	682	300	303	306
A.3.5.2	Tarifa për dhënien e licensave, lejeve e autorizimeve	576	382	1,107	1,107	1,118	1,129
A.3.5.3	Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit	4,337	-	650	3,480	3,515	3,550
A.3.5.4	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	187	286	350	-	-	-
A.3.5.5	Tarifa e licensimit të veprimtarive të transportit	-	-	-	-	-	-
A.3.5.6	Tarifa e parkimit për mjetet e licensuara dhe vendparkime publike	2,006	1,822	1,317	6,032	6,092	6,153
A.3.5.7	Tarifa për dhënie license për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	-	9,800	-	-	-	-
A.3.5.8	Tarifa për pyejt dhe kullotat	5,366	5,403	5,228	5,228	5,280	5,333
A.3.5.9	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja	427	238	400	356	360	364
A.3.5.10	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	5,140	5,512	5,075	6,387	6,451	6,516
A.3.5.11	Tarifa për trajtimin e mbetjeve inerte në landfille	-	-	-	-	-	-
A.3.5.12	Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)	-	-	-	-	-	-
A.3.5.13	Tarifa nga dokumentat për tender, ankand etj	561	466	500	360	364	368
A.3.6	**Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj**	5,057	7,787	9,815	11,126	11,238	11,351
A.3.6.1	Biblioteka	-	-	-	-	-	-

A.3.6.2	Muzeumet	1,116	1,370	3,087	3,050	3,081	3,112
A.3.6.3	Teatri	-	-	-	-	-	-
A.3.6.4	Qendra kulturore e fëmijëve	-	-	-	-	-	-
A.3.6.5	Pallati i sportit	-	-	-	-	-	-
A.3.6.6	Qendra Komunitare	-	-	-	-	-	-
A.3.6.7	Mensa (Konviktet)	387	-	-	-	-	-
A.3.6.8	Kopshtet	3,203	6,417	6,728	8,076	8,157	8,239
A.3.6.9	Çerdhet	351	-	-	-	-	-
A.3.7	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	-	-	-	-	-	-
A.3.8	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	151	185	-	116	117	118
A.3.9	Tarifa e përkohëshme	-	-	-	-	-	-
A.3.10	Tarifa të tjera	3,256	3,450	3,780	3,920	3,959	3,999
A.4	Të Ardhurat e Tjera	21,877	22,289	24,176	22,927	23,156	23,387
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	8,252	7,739	8,952	8,424	8,508	8,593
A.4.2	Kthimi nga investimet kapitale	-	-	-	-	-	-
A.4.3	Fitimi nga ndërmarrjet publike në varësi të Bashkisë	-	-	-	-	-	-
A.4.4	Kthimi nga partneriteti publik privat	-	-	-	-	-	-
A.4.5	Tërheqje e të ardhura krijuar nga shërbimet	-	-	-	-	-	-
A.4.6	Shitja e mallrave dhe shërbimeve	-	-	-	-	-	-
A.4.7	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	131	298	300	700	707	714
A.4.8	Sekuestrime dhe Zhdëmtime	-	16	-	-	-	-
A.4.9	Kuotat e anëtarësisë së bashkive	-	-	-	-	-	-
A.4.10	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	-	-	-	-	-
A.4.11	Grante nga ndihma ndërkombëtare	-	-	-	-	-	-
A.4.12	Shitja e aseteve financiare	-	-	-	-	-	-
A.4.13	Shitja e aseteve fikse të prekshme / paprekshme	-	-	-	-	-	-
A.4.14	Të tjera	13,494	14,236	14,924	13,803	13,941	14,080
B	Transferta nga Buxheti Qendror	399,435	567,295	595,957	475,513	475,513	489,334
B.1	Transferta e Pakushtëzuar	210,664	213,504	219,985	253,364	253,364	267,185
B.2	Transferta e Kushtëzuar	14,294	170,829	187,466	-	-	-
B.2.1	Për funksionet e deleguara	-	-	-	-	-	-
B.2.2	Për projekte të veçanta (FZHR dhe të tjera)	14,294	170,829	187,466	-	-	-
B.3	Trasferta e Pakushtëzuar Sektoriale	174,477	182,962	188,506	222,149	222,149	222,149
C	Huamarrja	-	-	-	-	-	-

C.1	Huamarrja Afatshkurtër	-	-	-	-	-	-
C.2	Huamarrja Afatgjatë	-	-	-	-	-	-
D	Trashëgimi nga Viti i Shkuar	69,078	107,476	189,159	-	-	-
D.1	Trashëgimi Pa Destinacion	48,105	75,068	166,200	-	-	-
D.2	Trashëgimi Me Destinacion	20,973	32,408	22,959	-	-	-
	TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË	641,560	874,553	995,486	705,990	708,294	724,443

Grafiku 1. Të Ardhurat e Bashkisë Gjirokastër sipas Burimit (në mijë ALL dhe në % ndaj totalit)



3.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Gjirokastër.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave të cilat krijohen dhe administrohen nën autonominë e Bashkisë Gjirokastër sipas legjislacionit në fuqi. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Planifikimi i të ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë , e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Bashkëpunimi i administratës së tatim taksave në bashki me komunitetin do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, me qëllim realizimin e objektivave madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë.

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke iu për afruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

Numri total i familjeve që parashikohet të përfshihet në skemën e detyrimeve fiskale është 8.587 familje. Për 1.026 familje janë parashikuar lehtësi fiskale për shkak të problemeve sociale. Bazuar në rregjistrin aktual, në total numri i bizneseve që parashikohen të përfshihen në skemën e detyrimeve fiskale është 1.323.

Biznesi i vogël zë 81% të numrit total, gjithashtu në detyrimet fiskale përfshihen edhe 39 institucione buxhetore.

Një faktor i rëndësishëm është planifikimi i mbështetur në shpërndarje sa më të drejtë të ngarkesës tatimore duke bërë përcaktimin e nivelit të tarifës sipas vendodhjes gjeografike, duke lehtësuar subjektin tatimpagues sipas taksimit të diferencuar. Ndërgjegjësimi biznesëve dhe qytetareve ndaj detyrimeve fiskale është një tjetër faktor i rëndësishëm.Të ardhurat për frymë janë llogaritur mbi numrin e përgjithshëm të banoreve të Bashkisë Gjirokastër dhe Njësive Administrative të marë nga Zyra e Gjendjes Civile, i cili është 52.000 banorë.

Rritja, rimëkëmbja ekonomike dhe pavarësia e njësisë së qeverisjes vendore është sfida kryesore e Bashkisë Gjirokastër. Me politikat fiskale ne synojmë që të kemi në dorë një mekanizëm i cili na ndihmon për të arritur objektivat në realizimin e prioriteteve të identifikuara në planet tona strategjike më afatgjata. Eksperienca, përballja me sfidat dhe problematikat, konsultimet me ekspertë dhe grupe interesi, por edhe vizioni i qartë i institucionit tonë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe të integruar, vijnë të konkretizuara në metodologjinë e vlerësimit të të ardhurave në periudhë afatgjatë.

Agroturizmi dhe prodhimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i ekonomisë në Gjirokastër. Zonat e prodhimit bujqësor dhe blegtoral në Gjirokastër, edhe pas disa investimeve të kryera në Njësitë Administrative, përballen me nevojën e madhe për mirëmbajtje dhe investime të tjera në kullim, vaditje, përmirësimin dhe krijimin e lerave te reja, mbjelljen e druve pyjore, përmirësimin e fondit pyjor, hartimin e planeve të menaxhimit të fondit kullosor dhe pyjor. Zbatimi Reformës Administrativo-Territoriale kanë treguar se ndryshimet e ndjeshme në sipërfaqe, numër popullsie, por edhe shërbime, kërkojnë angazhim më të mirë në përdorimin e fondeve.

Këto ndryshime po pasohen edhe me rikonceptime e ndryshime ligjore e nënligjore, si për organizimin e qeverisjes, buxhetimit, sistemit fiskal e për të gjitha fushat të cilat i kanë kaluar në funksion të këtyre njësive. Të gjitha këto ndryshime që janë bërë në vazhdimësi do të shërbejne si instrument për rritjen e efiçencës administrative, profesionale dhe teknike të qeverisjes vendore, nëpërmjet rritjes së të ardhurave, për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët.

Nivelet e taksave vendore, janë kryesisht të miratuara me ligj nga Kuvendi i Shqipërisë, por për nevoja të qeverisjes vendore dhe në konsultim me komunitetin, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të miratojë edhe taksa të përkohshme, që i shërbejnë një objektivi të caktuar për përmirësimin e situatave në infrastrukturë e territorin brenda juridiksionit të bashkisë.

3.1.2 Burimet e të ardhurave dhe metodologjia e parashikimit afatgjatë të tyre

Burimet e financimit të Bashkisë Gjirokastër përbëhen prej të ardhurave nga taksat e tarifat vendore të njësisë administrative Gjirokastër dhe gjashtë njësive administrative të tjera, duke përfshirë dhe donacionet e ndryshme si dhe të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar dhe ajo e kushtëzuar nga pushteti qëndror.

3.1.2.1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohet çdo person fizik, juridik, vendas ose i huaj që zotëron një pasuri të paluajtshme brenda territorit të Republikës së Shqipërisë pavarësisht nga niveli i përdorimit. Në këtë taksë përfshihen:

- Taksa mbi ndërtesat
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

Taksa mbi ndërtesën

Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.
Sipërfaqja e ndërtesës, në përdorim apo pronësi, përcaktohet në bazë të dokumenteve, që vërtetojnë përdorimin ose pronësinë e saj.

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen, individët, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përvec rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.
2. Taksapagues është individi, personi fizikë ose juridik pronar i ndërtesës, personi që ka aplikuar për legalizim të ndërtesës sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje" ose ai që e shfrytëzon ose përdor ndërtesën, nëse pronari nuk mund të përcaktohet ose nuk gjendet.
3. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.
4. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë paguhet çdo muaj.

Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat:

a) pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarresi me qira të paliberarizuara;
c) banesat sociale në pronësi të bashkive;
d)pasuritë e paluajtshme - ndërtesa, pronë e subjekteve juridikë ose fizikë, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
e) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
t) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;

g) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgimine kulturore.

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

1. **0,05%,** për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;
2. **0,2%,** për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike; Sipërfaqe për tregti e shërbime, ndërtim, sipërfaqe prodhimi, zona muzeale do të jetë 185 lekë/m^2, ndërsa për veprimtari bujqësore dhe blegtorale do të jetë 37 lekë/m^2.
3. **30%** e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. (Këtu përfshihen edhe sipërfaqet të cilat janë të pashfrytëzueshme).

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijon:

a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim.

b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar.

c) 30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta perfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. (Këtu përfshihen edhe sipërfaqet të cilat janë të pashfrytëzueshme).

Tabela 3. Taksa mbi ndërtesat

Taksa mbi ndërtesat	Shkalla e taksës	Niveli i taksës
a-Ndërtesa banimi (70 m) pa vërtetim hipotekor para vitit 1993 b. Ndërtesa banimi (100 m) pa vërtetim hipotekor pas vitit 1993	0.05 %	24 lekë/m^2
a/1 Ndërtesa banimi para 1993 (në bazë të vërtetimit hipotekor të paraqitur nga qytetari)	0.05 %	24 lekë/m^2
b/1 Ndërtesa banimi pas 1993 (në bazë të vërtetimit hipotekor të paraqitur nga qytetari)	0.05 %	24 lekë/m^2
d-Sipërfaqe për tregti e shërbime, ndërtim, sipërfaqe prodhimi, Zona muzeale.	0.2%	185 lekë/m^2

c-Sipërfaqe për veprimtari bujqësore dhe blegtorale	0.2%	37 lekë/m²
d)30% e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta perfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. (Këtu përfshihen edhe sipërfaqet të cilat janë të pashfrytëzueshme).	30%	55 lekë/m²

2.b) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqesore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka.

Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, janë si më poshtë:

Tabela 4. Taksa mbi tokën bujqësore

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	2,800
II	2,100
III	1,400
IV	1,350
V	1,250
VI	1,200
VII-X	1,100

Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi tokën bujqësore është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave.

Taksa mbi truallin

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja në metër katror e tokës (jo bujqësore) brenda vijës kufizuese të ndërtesës e vërtetuar me dokumenta ligjor. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e

truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

	Vlera e taksës në lekë/m²/vit për qëllime banimi nga individët	Vlera e taksës në lekë/m²/vit për qëllime biznesi
Bashkia Gjirokastër	0,28 lekë/m²	15 lekë/m²

Grafiku 2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme në tre vite 2020-2021-2022.



Grafiku 3. Të ardhurat për vitin 2020-2021 (plan-fakt).



Krahasimi i parashikimit të të ardhurave përgjatë 2 viteve të fundit tregojnë rritje progresive faktnë trendin e të ardhurave. Përsa i përket vitit 2020 kemi një realizim të të ardhurave në masën 85 %, për vitin 2021 kemi një realizim në masën 99 %.

Referuar vitit 2020 duhet të merret në konsiderat situata e vështirë me të cilën u përball gjithë republika dhe jo vetëm por gjithë bota.

Sipas të dhënave të ilustruara në grafik duket qartë tendenca e rritjes së mbledhjes së të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, e cila vjen për shkak të ristrukturimit të Drejtoriasë së të ardhurave, pronave publike, lejeve dhe lishencave duke bashkëpunuar me Drejtoritë e tjera. Kjo tendencë parashikohet të mbahet edhe për vitin 2022 duke u bazuar edhe te ndryshimet e propozuara në paketën fiskale.

Të ardhurat e veta përfshijnë të gjitha burimet e të ardhurave, me përjashtim të transfertës të pakushtëzuar nga pushteti qëndror. Këto burime të ardhurash bashkia i përdor për financimin e funksioneve të përcaktuara nga Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore". Planifikimi i te ardhurave nga taksat/tarifat është mbështetur në paketën fiskale të Bashkisë , e cila përcakton llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë. Paketa fiskale përcakton rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e

taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre. Bashkëpunimi i administratës së tatim taksave në bashki me komunitetin do të mundësojë sigurimin e të ardhurave, me efekt përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve që ofron bashkia ndaj qytetarëve të saj, me qëllim realizimin e objektivave madhorë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të bashkisë.

Paguesit e nivelit të taksave dhe tarifave vendore janë bizneset, institucionet dhe familjet e të gjitha njësive administrative. Parashikimi i të ardhurave nga familjet është bërë duke ju përafruar kapaciteteve reale të familjeve rezidente dhe duke mesatarizuar numrin e arkëtimeve në vitet e kaluara sipas zonave me numrin e familjeve.

3.1.2.2 Taksa e tabelës

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qëndrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Tabelat kategorizohen në:
i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një tabele identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.
ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.
iii) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qëndrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.
iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj.

Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga gërma të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasade të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi njq sipqrfaqe ekzistuese, si bazq vlerqsimi pqr llogaritjen e taksqs shqrben sipqrfaqja qq zënë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe gërma, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabele.

Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.

Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelë identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij.

Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelë. Kjo taksë aplikohet për të gjitha subjektet fizikë, juridikë, private e shtetërore, vendas apo të huaj që kryejnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të Bashkisë Gjirokastër.

Niveli i kësaj taksë për Bashkinë Gjirokastër është si më poshtë vijon:

Tabela nr.5.Taksa e tabelës

Nr	Llojet e tabelave	Nj/matëse	Niveli i taksës
1	**Taksë tabele për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo, brenda territorit, ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve (ku shënohet emri dhe /ose aktiviteti i biznesit)**		
a	Deri në 2 m^2	Lekë/m^2	0
b	**Mbi 2m^2 deri 10 m^2**		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	10,000
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	15,000
	-elektronike	Lekë/m^2	20,000
c	**Mbi 10m^2 deri 20 m^2**		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	8,500
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	12,750
	-elektronike	Lekë/m^2	17,000
d	**Mbi 20m^2 deri 40 m^2**		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	5,500
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	8,250
	-elektronike	Lekë/m^2	11,000
e	**Mbi 40 m^2**		
	-e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	4,000
	e thjeshtë (pa ndriçim)	Lekë/m^2	6,000
	-elektronike	Lekë/m^2	8,000

2	**Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m²**		
	-E thjeshtë (me/pa ndriçimi)	Lekë/m²/vit	22,500
	-Elektronike	Lekë/m²/vit	45,000
3	**Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.**		
	-Të të gjitha llojeve dhe përmasave	Lekë/m²/dite	1,000

Detyrimi dhe kështet e pagesës:

- Detyrimi i taksës së tabelës për qëllime reklamimi për subjektet që aktiviteti kryesor i tyre është reklamimi do të ndahet në katër këste 3-mujore sipas akt-marrëveshjeve të lidhura me Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave.
- Për subjektet e reja të hapura gjatë vitit, taksa e tabelës do të llogaritet proporcionalisht me ditët e ushtrimit të aktivitetit, pra që nga data e regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Lishencave .

3.1.2.3 Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset për ndërtesat dhe të gjitha pasuritë e paluajtshme në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, parakryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet.

Baza e taksës për kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre, dhe niveli tregues i taksës është 2 % per qind.

